

31245

REPUBLIKA SHQIPERISE
GJYKATA SHKALLES SE PARE TIRANE
NR__Vendimi 31245

VENDIM PER REGJISTRIMIN

E PERSONIT JURIDIK

Ne Tirane , me date 15/11 2004 , Une gjyqtar i Gjykates se Shkalles se Pare Tirane C. 37 , si shqyrtova kerkesen e kerkuesit , per regjistrimin si person juridik te shoqerise "MARSI 4 " sh.p.k.

KONSTATOVA

- Se me date 10.02.2004 eshte krijuar shoqeria "MARSI 4 " sh.p.k. me ortake te vetem zotin Viktor Breshani ,me seli ne Tirane , rr. "S. Zorba, banesat e reja, me objekt: Tregtim me shumice dhe pakice import-eksport artikuj te ndryshem, ushqimore, industriale, bujqesore, pije freskuese dhe alkoolike, materiale ndertimi, inerte, parafabrikate, hidrosanitare, ndertim, montimi, vegla auto, makineri e paisje, pjese kembimi, autoshkolla, lavazh, bilardo, bar, restorant, zyre konsulence ne fushen juridike, financiare, hartim e zbatim projektesh, agjensi per shitblerje, dhenie me qera pasuri te tundeshme dhe te patundeshme, agjensi komisionere si dhe ne fushen e transportit te mallrave dhe te pasagjereve, brenda dhe jashte vendit, prodhime duralumini,
- me kapital themeltar 100-000 leke
- me administrator Viktor Breshani

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit Nr. 7638 , dt 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare" dhe ligjit Nr. 7667 , dt 28.1.1993 "Per regjistrin tregtar";

V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.

Regjistrimin si person juridik te shoqerise tregtare "MARSI 4 " sh.p.k me ortake te vetem zotin Viktor Breshani

- Me objekt; Tregtim me shumice dhe pakice import-eksport artikuj te ndryshem, ushqimore, industriale, bujqesore, pije freskuese dhe alkoolike, materiale ndertimi, inerte, parafabrikate, hidrosanitare, ndertim, montim, vegla auto, makineri e paisje, pjese kembimi, autoshkolla, lavazh, bilardo, bar, restorant, zyre konsulence ne fushen juridike, financiare, hartim e zbatim projektesh, agjensi per shitblerje, dhenie me qera pasuri te tundeshme dhe te patundeshme, agjensi komisionere si dhe ne fushen e transportit te mallrave dhe te pasagjereve, brenda dhe jashte vendit, prodhime duralumini, Me seli ne Tirane , Rr. "S.Zorba, banesat e reja.

1. Me kapital themeltar 100.000 leke.

2. Administrator eshte Viktor Breshani

Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit.

Tirane, me 15.3.2001

GJYQTAR

Arbule
Pajon
[Signature]

31245

URDHER REGJISTRIMI

- a) MARSII 4 SHPK
- b) Tirane, rruga 5 Maji
- c) Ne fushen e tregtimit me shumice e pakice, import eksport te artikujve te ndryshem ushqimore, industriale, bujqesore, pije freskuese etj.

Ç) 100.000 leke te derdhura

Ortak Viktor Breshani

Administrator Viktor Breshani

Akti i themelimit 2 flete

Statuti 6 flete

Data e nenshkrimit 10.02.2004-

Data e regjistrimit 04.03.2004

11.

GJYQTARE

Ortaku

[Signature]

AKTI 1 THEMELIMIT

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " MARSII 4" sh.p.k.

Duke u bazuar ne , ligjin Nr 7512 , dt 10.8.1991 -" Per sanksionimin dhe mbrbjtjen e prones private, te nismes se lire dhe privatizimit" , ligjin Nr 7638 , dt 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligjin Nr 7667 , dt 28.1.1993 " Per regjistrin tregtar", me vullnetin e saj te lire, te shprehur dhe ne nenskrimin e ketij akti themelimi formohet SHOQERIA ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "MARSII 4"

1.1. Formimi i shoqerise

Ortaket e shoqerise " MARSII 4 " sh. p.k.
Viktor Breshani, i biri i Myrdarit, i dt 1958, lindur ne Selenice, banues ne Tirane.rr.S.Zorba, banesat e reja.

1.2 Emri i shoqerise

Shoqeria qe krijohet emertohet" **MARSII 4 "sh.p.k.**

1.3 Qellimi dhe objekti i shoqerise tregtare do te jete :

- tregtim me shumice dhe pakice; import-eksport artikuj te ndryshem, ushqimore, industriale, bujqesore, pije freskuese dhe alkoolike, materiale ndertimi, inerte, parafabrikate, hidrosanitare, ndertim, montim, vegla auto, makineri e paisje, pjese kembimi, autoshkolla, lavazh, bilardo, bar, restorant, zyre konsulente ne fushen juridike, financiare, hartim e zbatim projektesh, agjensi per shitblerje, dhenie me qera pasuri te tundeshme dhe te patundeshme, agjensi komisionere si dhe ne fushen e transportit te mallrave dhe te pasagjereve, brenda dhe jashte vendit, prodhime duralumini.

1.4 Selia

Selia e shoqerise "MARSII 4" sh.p.k. eshte ne Tirane, rruga S. Zorba, banesat e reja. Sipas vendimeve te miratuara ne statutin e shoqerise ajo mund te hape zyra , perfaqesi dhe filiale te saj ne qytete te tjera brenda dhe jashte Shqiperise.

1.5 Afati i shoqerise

Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise eshte 10 vjet. Si date e fillimit do te jete data e regjistrimit te shoqerise ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane .

1.6 Kapitali themeltar i shoqerise

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke qe perbe kontributin e ortakut te vetem te shoqerise ne raportin 100%

2 . KAPITALI

2.1 Kontributet e kapitalit

Sasia e kapitalit te derdhur sipas dispozites se kesaj akti mareveshjeje do te quhet kapital themeltar.

Bilanci i shoqerise -

Ne masen e duhur shoqeria ka te drejte te siguroje financimin fregtar ose investues nga cdo Banke e Institucion financiar i huaj ose shqiptar. Ky financim rregullohet me ane te kontratave te vecanta .

2.3 Llogaria e shoqerise dhe ceshtjet financiare

,/Shoqeria "MARSI 4" sh.p.k. i mban llogarite duke u l-" mbeshtetur mbi bazen te lekut shqiptar si dhe tek valutat e qendrushme. Shoqeria do te kete si vit fiskal vitin kalendarik.

3. Organizimi dhe drejtimi

3.1 Shoqeria "MARSI 4" sh.p.k. ka keto organe drejtuese:

-Asambleja e ortakeve (ortaku i vetem)


3.2 Administrator i shoqerise eshte Viktor Breshani. **Dispozita**

te fundit

Akti I themelimit perpilohet ne gjuhen shqipe sot ne date 11.02,2004

ORTAKU I VETEM


VIKTOR BRESHANI



REPUBLIKA SHQIPERISE

NR REP 1146

Dhoma e Noterise Tirane



VERTETIM

Vertetohet se sot me dt 11.02.2004 ne (dymije e kater) ne dhomen e noterise Tirane dhe para meje notere Violeta Sulkaj , u paraqit Viktor Breshani, i biri i Myrdarit, i datelindjes 1958, lindur ne Selenice, banues ne Tirane,, Rruga "S. Zorba", banesat e reja, per identitetin e te cilit u sigurova ne baze te leter njoftimit personal dhe pasi u sigurova se i ka te gjitha aftesite e kerkuara nga ligji , i vertetova nenshkrimin e aktit te mesiperm te redaktuar jashte kesaj zyre.

NOTERE



STATUT

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "MARSI 4" sh.p.k.

KREU 1 EMERTIMI , OBJEKTI 1 VEPRIMTARISE , SELIA ,

KOHEZGJATJA

Neni 1 EMERTIMI

Duke u bazuar ne ligjin Nr 7512 dt 10.8.1991 -"Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private , te nismes se lire dhe privatizimit" , te ligjit Nr 7638 , dt 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligjit Nr 7667 , dt 28.1.1993 "Per regjistrin tregtar", me vullnetin e tij te lire , te shprehur dhe ne nenshkrimin e ketij akt themelimi qe i bashkangjitet ketij statuti, sot me 11.02.2004 ortaku i vetem :

- **Viktor Breshani** i biri i Myrdarit , i datelindjes 1958 ,lindur ne Selenice, banues ne Tirane, rruga "S. Zorba", banesat e reja.
krijon shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "MARSI 4" sh.p.k.

Neni 2

Shoqeria "MARSI 4"sh.p.k. eshte krijuar ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe si person juridik e fillon aktivitetin e saj me regjistrimin ne Regjistrin Tregtar.

Neni 3

Selia e shoqerise

Selia e shoqerise gjendet ne Tirane , rruga S.Zorba, banesat e reja . Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj me vendim te Asamblese se Ortakeve (ortaku i vetem)

Neni 4

Shoqeria e zhvillon aktivitetin e saj ne territorin e Republikes se Shqiperise ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe me statutin e saj . Shoqeria mund te krijojte filiale ne vende te tjera ne perputhje me legjislacionin e vendit perkates.

Neni 5
FUSHA E AUTORITETIT TE ORTAKEVE(ORTAKU I VETEM)

Fusha e autoritetit te ortakeve(ortakut te vetem) dhe pergjindja e fitimeve dhe humbjeve do te kene si kriter baze kapitalin e shoqerise si dhe kompetencat qe gezon ne marrjen e vendimeve te cdo karakteri , te percaktuara ne kete statut.

Neni 6
LIBRI I SHOQERISE

Per te precizuar e per te saktësuar veprimtarine e vet ekonomike si dhe marredheniet e punes , shoqeria do te cete librin e vet , i cili do te quhet libri I shoqerise.

Neni 7
KONFIDENCIALITETI

Ortaku I vetem si dhe personat e tjere te pranuar ne shoqeri , bien dakord qe te mos i ekspozojne asnje personi te jashtem informacionet qe do te disponoje shoqeria , kontratat qe ajo do te lidhe si dhe planet ose qellimet qe ajo ka per te ardhmen e saj.

Neni 8

Te gjitha aktet dhe dokumentat qe nxirren nga shoqeria te destinuara per te tretet , si letrat , faturat , lajmerimet dhe publikimet e ndryshme, etj, duhet te tregojne lexueshem emrin e shoqerise dhe pas tij fjalet shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ose inicialet sh.p.k. dhe emrin e administratorit

Neni 9
Shoqeri ka si objekt te veprimtarise saj

Tregtim me shumice dhe pakice import-eksport artikuj te ndryshem, ushqimore, industriale, bujqesore, pije freskuese dhe alkoolike, materiale ndertimi, inerte, parafabrikate, hidrosanitare, ndertim, montim, vegla auto, makineri e paisje, pjese kembimi, autoshkolla, lavazh, bilardo, bar, restorant, zyre konsulente ne fushen juridike, financiare, hartim e zbatim projektesh, agjensi per shitblerje, dhenie me qera pasuri te tundeshme dhe te patundeshme, agjensi komisionere si dhe ne fushen e transportit te mallrave dhe te pasagjereve, brenda dhe jashte vendit, prodhime duralumini.

Neni 10
KOHEZGJATJA

Jetegjatesia e shoqerise do te jete 10 vjet , por ajo mund te shperndahet dhe para ketij afati te percaktuar me siper me vendim te Asamblese se Ortakeve(ortakut te

vetem) te shoqerise si dhe kur merr fund aktiviteti i saj apo kur shperndarjen e saj e percakton ligji.

KREUII

Neni 11

Kapitali themeltar, kuotat

Kapitali themeltar i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "MARS 4" sh.p.k. eshte 100.000 (njqind mije) leke. Ky kapital eshte teresisht i nenshkruar dhe i shlyer nga ortakut. Shoqeria mund ta shtojte ose pakesoje kapitalin e saj deri ne limitin e percaktuar me ligj, me vendim te Asamblese se Ortakeve (ortakut te vetem).

Neni12

Kapitali themeltar perbehet nga kontributi i meposhtem :
Viktor Breshani 100.000(njqind mije) leke ose 100% te kapitalit themeltar.

Neni13

Kapitali themeltar eshte lirisht i transferueshem tek personat e trete, nqs Asamblea e Ortakeve(ortaku i vetem) te shoqerise vendos per kete . Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme ne rast ndarje pasurore mes bashkeshorteve si dhe ne rruge trashegimie .Transferimet e pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohen me akt noterial .

Neni14

Asamblea e Ortakeve(ortaku i vetem) miraton llogarite , nese eshte e nevojshme pas raportit te eksperteve kontabel te autorizuar, brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar, merr vendim per ndryshimet qe mund te pesoje statuti, per ndryshimin e mases se kapitalit themeltar dhe shnderrimin e shoqerise ne nje forme tjeter, per punesimin e punonjesve dhe pagat, si dhe probleme te tjera te lidhura me punesimin ne zbatim te legjislacionit shqiptar etj. Vendimet e Asamblese se Ortakeve(ortaku i vetem) evidentohen ne nje regjister.

ORGANET DREJTUESE

Neni15

Organi vendimor i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "MARS 4" sh.p.k. eshte Asamblea e Ortakeve (ortaku i vetem) te shoqerise e cila zgjedh administratoret qe do te hyjne ne marredhenie me te tretet.

Neni16

Shoqeria , drejtohet nga nje administrator funksion qe kryhet nga Viktor Breshani te ciles i atribuohen te gjitha kompetencat, pervec atyre te cilat ligji ia njej shprehimisht Asamblese se Ortakeve(ortaku i vetem).

Neni 17

LIBRAT E SHOQERISE, BILANCI, SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI

Shoqeria eshte e detyruar te mbaje pervec dokumentacionit kontabel ose librave te tjere edhe:

Librin e shoqerise , ne te cilin shenohet emri i ortakeve, kapitali themeltar, si dhe vendimet e Asamblese se Ortakeve(ortaku i vetem).

Neni 18

PUNESIMET NE SHOQERI

Per punonjesit qe do te punesohen , maredheniet juridike midis shoqerise dhe te punesuarve do te rregullohen me kontrate pune ne perputhje me dispozitat ligjore dhe Kodin e Punes.

Neni 19

Shoqeria merr persiper te derdhe rregullisht te gjitha detyrimet, gjithashtu dhe kontributet per sigurimin e te punesuarve te saj ne organet kompetente perkatese sipas ligjit.

Neni 20

BILANCI

Bilanci mbyllet me dt 31 Dhjetor te cdo viti. Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabel i autorizuar nga administratori , miratohen nga Asamblea e Ortakeve(ortaku i vetem).

Neni 21

SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI

Shoqeria mbaron me vendim te Asamblese se Ortakeve (ortaku i vetem), ose kur ka nje prishje te parakoheshme per arsyt e parashikuara ne ligj.

Neni 22

Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi , Asamblea e Ortakeve (ortaku i vetem) cakton nje ose disa likujdatore , te cilet i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe te pasivit te shoqerise , mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe mbi afatin e nevojshem te perfundimit te tyre.

Ne fund te procesit te likujdimit , Asamblea e Ortakeve(ortaku i vetem) vendos mbi bilancin perfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit te likujdimit . Pas pagimit te likujdatoreve Asamblea e Ortakeve (ortaku i vetem) mban pjesen e mbetur te kapitalit.

Neni 23
ZGJIDHJA E MOSMAREVESHJEVE

Te gjitha mosmareveshjet qe mund te lindin gjate ekzistences se shoqerise ose gjate periudhes se likujdimit do t'i paraqiten per zgjidhje gjykates kompetente.

Neni 24
DISPOZITA TE FUNDIT

Ky statut u hartua ne 3 tre kopje ne gjuhen shqipe, duke patur sejcila kopje fuqi te njejte ligjore.

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut , do te zbatohet ligji " Per Shoqerite tregtare" dhe Kodi Civil ne fuqi ne Republiken e Shqiperise .

ORTAKU I VETEM

Viktor Breshani

Viktor Breshani
Breshani

DHOMA E NOTERISE TIRANE


Nr. Rep 1144

VERTETIM


Vertetohet se sot me dt 11.02.2004 ne dhomen e noterise Tirane dhe para meje notere Violeta Sulkaj , u paraqit Viktor Breshani , i biri i Myrdarit , i datelindjes 1958 , lindur ne Selenice, banues ne Tirane , rruga "S. Zorba" banesat e reja, per identitetin e te cilit u sigurova ne baze te leter njoftimit personal dhe pasi u sigurova se i ka te gjitha aftesite e kerkuara nga ligji , i vertetova nenshkrimin e aktit te mesiperm : te redaktuar jashte kesaj zyre.

NOTERE

Violeta SULKAJ



REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA Tirane
NR. 146 Rep.



VERTETIM

Vertetohet se sot me date 10.02.2004 para meje noteres Violeta Sulkaj u paraqit kerkuesi Viktor Breshani, per identitetin e te cilit u sigurova nga leternjoftimi perkates, madhore , me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili depozitoi shumen 100.000 leke per shoqerine MARSISHPK ne krijim e siper, bazuar ne ligjit 7638, date 19.11.1992 "PER SHOQERITE TREGTARE".

NOTERE
Violeta Sulkaj

A handwritten signature in black ink, appearing to be "V. Sulkaj", written over a large, faint oval shape.

31245

3 E Baye
02 08 03 2004
MARS

KERKESE

KERKUESE : Viktor Breshani, i biri i Myrdarit, i datelindjes 1958, banues ne Tirane, rr. S. Zorba, banesat e reja.

OBJEKTI: Kerkohet regjistrimi si person juridik i shoqerise " MARSII "sh.p.k

REJTUAR: GJKATES SE SHKALLES SE PARE

TIRANE

Eshte krijuar shoqeria "MARSII" sh.p.k me ortak te vetem dhe administrator Viktor Breshani, me objekt Tregtimi me shumice dhe pakice import-eksport artikuj te ndryshem, ushqimore, industriale, bujqesore, pije freskuese dhe alkoolike, materiale ndertimi, inerte, parafabrikate, hidrosanitare, ndertim, montim, vegla auto, makineri e paisje, pjesa kembimi, autoshkolla, lavazh, bilardo, bar, restorant, zyre konsulence ne fushen juridike, financiare, hartim e zbatim projektesh, agjensi per shitblerje, dhenie me qera pasuri te tundeshme dhe te patundeshme, agjensi komisionere si dhe ne fushen e transportit te mallrave dhe te pasagjereve, brenda dhe jashte vendit, prodhime duralumini, me seli ne Tirane, Rr. 5 Maji

Per kete qellim kerkohet regjistrimi si person juridik i kesaj shoqerise prane Gjykates se Shkalles se Pare.

KERKUES
Viktor Breshani

PUBLIKA SHOQERISE
OMA E NOTERISE TIRANE

Nr. Rep 49

VERTETIM

Merretet se sot me daten 10.9. 2004 ne dhomen e noterise Tirane dhe para meje notere Violeta Sulka, u paraqit Viktor Breshani, i biri i Myrdarit i datelindjes 1958, lindur ne Selenice, banues ne Tirane, rruga " S. Zorba, banesat e reja, per identitetin e te cilit u sigurova ne baze te leter njoftimit personal dhe pasi u sigurova se i ka te gjitha aftesite e kerkuara nga ligji, i vertetova nenshkrimin e aktit te mesiperem te redaktuar jashte kesaj zyre.

NOTERE
VIOLETA SULKAJ

